

| | |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | Nr. Prot. |
| Dep. | Br.Prot. |
| Dep. | Prot No. |
| 2-D DPK | 01-3295/AS |
| Nr. i faq. | Data |
| Broj stranica | Datum |
| Nr. pages | Date |
| 03 | 14-10-2015 |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 14.10.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Ekziston konflikt interes i dhe kufizim në ushtrimin e funksionit publik në rastin me Nr. AKK-03-02-2012/15 për zyrtarin e lartë z.Afrim Shabani – Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe njëkohësisht u.d. i detyrës së Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë.

II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.

IV. Të gjitha vendimet qe i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike ne ueb faqen zyrtare te Agjencisë.

V. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit .

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin Për Parandalimin e Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. 04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3) si dhe në bazë të vendimit nr. AKK-03-02-2012/15, është hapur rasti nen dyshimin e bazuar për papajtueshmëri dhe konflikt interesit në ushtrimin të funksionit publik për zyrtarin e lartë, z.Afrim Shabani, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Komunës së Podujevës dhe njëkohësisht u.d. i Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë.

Fillimisht zyrtari te lartë z.Afrim Shabani i është bërë shkresa e parë njoftuese për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit pas së cilës kemi organizuar takim në zyrat e AKK-së. Ai është njoftuar me faktet që posedon Agjencia për këtë rast në lidhje me situatën e mundshme të konfliktit të interesit, respektivisht kufizimet që parashihen për zyrtarët e lartë me Ligjin nr.04/L-051 Për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 PËR VETËQEVERTISJEN LOKALE.

Zyrtari i larte z.Afrim Shabani është njoftuar në këtë takim se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtari lartë, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Komunës së Podujevës, nuk mund të ushtroj funksionin si u.d. i Drejtorisë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë, pasi qe kjo situatë cilësohet si kufizim i zyrtarit të lartë në ushtrim të funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik si Këshilltar Komunal pasi qe sipas nenit 16.1 te Ligjit nr.04/L-051 për thotë se: Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizatat fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit.

Ndërsa neni 65.2 i Ligjit Nr.03/L-040 PËR VETËQEVERTISJEN LOKALE situatën në fjalë e cilëson si te ndaluar: Drejtoret komunal, drejtoret e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të kuvendit te Republikës së Kosovës apo kuvendit të komunës të komunës ku ata punojnë.

Zyrtari i lartë z.Afrim Shabani, ka theksuar se ai është emëruar me datë 15.06.2015 nga kryetari i Komunës se Podujevës me një vendim qe ti ushtroj përkohësisht detyrat e drejtorisë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë deri në zgjedhjen e Drejtorisë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare sipas procedurave të rekrutimit, ndërsa është zotuar se do te konsultohet me udhëheqësit dhe do të ndërmarr veprimet sipas ligjit.

Pas këtij takim zyrtari i lartë z.Afrim Shabani nuk ka reflektuar dhe nuk ka ndërmarr asnjë veprim, Prandaj, me date 16.09.2015 Agjencia kundër Korrupsionit, konform nenit 18 paragrafi 5 te Ligjit PKI, zyrtarit të lartë z.Shabani, i ka bërë edhe shkresën e dyte (paralajmëruese) në të cilën e njofton atë për situatën e konstatuar në të cilën ndodhet, për masat tjera që mund të pasojnë nëse gjendja nuk ndryshon dhe njëkohësisht i jep afat të ri, por të kufizuar ligjor për ta ndryshuar këtë gjendje duke shmangur gjendjen e kufizimit të zyrtarit te lartë në ushtrim te funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik dhe konfliktit të interesit, si dhe dispozitën nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Në bazë të nenit 7 te Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, zyrtari i lartë ka për obligim ti zbatoj Parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit.

Zyrtari i lartë z.Afrim Shabani, nuk i ka përfillur afatet dhe deri me sot nuk ka marrë veprimet e nevojshme për shmangjen e gjendje se konflikti të interesit.

II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin publik që të filloj procedurën për shkarkimin e tij. Kjo bazuar ne nenin 18 (pika 8) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit i cili thotë: “*Ne rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij*”.

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni 20, pika 1, “*Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3*”.

Sipas Nenit 20 pika 2, "Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përvèç dënimit gjykata mund t'i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit".

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni /